

Pasaktësi të kryeministrit, me tokën

[Gazeta shqiptare, 26.3.2006]

Asnjëri nuk duhet t'ia futë kot, e aq më pak një kryeministër, e as ky yni—për eufemizëm, “futjen kot” po e zëvendësojmë me fjalën “pasaktësi”. Nuk ka sepse të bëjë me faj as këshilltarët e tij, as njeri tjetër veç vetes: ai ka marrë përsipër të flasë për çdo gjë vetë, pa lënë njeri tjetër të hapë gojën, prandaj duhet të marrë përsipër edhe përgjegjësitë e pasaktësive që deklaroi, së paku të kërkojë falje publikisht.

Po citojmë se ç' tha kryeministri në mbledhjen e grupit parlamentar të PD-së, e cila u transmetua më 19.3.2006, nga RTSH:

“Është një ligj [ligji për “legalizimet”, i kthyer nga Presidenti-sh.i] që ka marrë mbështetje popullore më shumë se çdo ligj tjetër në historinë e këtij parlamenti—mbasi ka qenë i zbërthyer tërësisht në frymën e tij, gjatë të gjithë fushatës elektrorale. Së dyti, ligji që kemi miratuar është kushtetues dhjetra, për të mos thënë qindra herë më shumë se ligji 7501. Në, me ligjin 7501, ligjëvënësi i lejoi vetes tagrën e shpronësimit jo për qëllime publike, por për të pronësuar të tjerë, jo 600 apo 700 hektarë, siç është ligji që ne miratuam, por fiks 500 000 ha.”

Po analizojmë me radhë, vetëm nja 5-6 pasaktësi që hasen në paragrafin e mësipërm:

1—Ligji për “legalizimet”, ai që ka kthyer presidenti, pronësoka “vetëm me 600 apo 700 hektarë”. Jo, sasia e vërtetë duhet të jetë shumë herë më e madhe, me mijra hektarë. Pjestoni “600 apo 700 hektarët”, me rreth “200 mijë familjet” e grabitësve, dhe do të rezultojë se i bie, sipas shifrave të kryeministrit, vetëm rreth 27 apo 32 metër katror për çdo familje!

“Jo të gjithë 200 mijët kanë pushtuar tokë,”—po prap, sado t'i zvogëlosh, nuk shkojnë dot te 300-500 metrat katror për çdo familje.

“700” hektarë janë tokat e ishpronarëve që i kanë pushtuar...!”—thënie që tingëllon njësoj si të ndash paratë në xhep: ky 50 leksh është kusur nga kafja, e ky 50 lekshi tjetër, nga buka etj. Tokat janë njëlloj, si ato që kanë qenë pronë e familjeve, si ato të institucioneve fetare e si ato të shteti. Të gjitha janë njësoj në pronësi të shtetit, për t'u përdorur për kthim-kompensim për ishpronarët—ky ka qenë premtimi i PD-së që në vitin 1995, dhe bile akoma është një ligj në fuqi!

2—Me “ligjin 7501”, qenkan “shpronësuar të tjerë, për të pronësuar të tjerë” me “fiks 500 000 hektarë”. Me ligjin për tokën bujqësore, u pronësuan edhe pronarë të vjetër (të para vitit 1945). Në shumë raste, sidomos në zonat jo fushore, toka u nda, nga komisionet e fshatit, sipas pronësisë së para vitit 1945. Kështu, pronarët e vjetër rezultoi se kanë marrë rreth 260 417 hektarë, dhe vetëm rreth 148 277 hektarë tokë u janë ndarë pronarëve që nuk kanë pasur tokë, pra “pronarëve të rinj”, e jo “fiks 500 000 hektarë”.

3—Krahason hektarët e ligjit 7501, me hektarët e ligjit të “legalizimeve”, duke mbjellur opinionin se gjoja kushtokan me qindra herë më shumë ato të “ligjit 7501”. Kjo tingëllon njësoj si krahasimi “3 kamjona me 7 bataliona” (cituar i marrë nga një skeç satirik mbi një kapter

idiot). Nuk krahasohen dot hektarët, por vlera në para e tokave. Është si të krahasosh 7 000 bidona me mjaltë (si hektarët e tokës afër qyteteve, me ligjin e “legalizimeve”), me 150 000 bidona me ujë (si hektarët e tokës në fshat, që u dhanë me ligjin 7501). Vlera mesatare e një bidon mjaltë është së paku sa e 40 bidonave me ujë, prandaj i bie të kenë vlerë më të madhe bidonat me mjaltë se ata me ujë!. Edhe hektari i tokës afër qyteteve (ai “i legalizimeve”), kushton shumë herë më tepër (mbi 40 herë më tepër) se hektari i tokës në fshat (ai i ligjit 7501), prandaj i bie të ketë vlerë më të madhe toka që do “të legalizojë” (të na grabisë) kryeministri ynë, sesa e gjithë toka për pronarët e rinj, ajo sipas ligjit 7501

4—Kuvendi, në vitin 1991, i paska lejuar “vetes tagrën e shpronësimit jo për qëllime publike”. Toka, në vitin 1991, ishte pronë e shtetit, si rezultat i Kushtetutës në fuqi, asaj të vitit 1976. Kuvendi u dha fshatarëve një pronë të shtetit; nuk qe Kuvendi i 1991 që i shpronësoi pronarët e para vitit 1945, por komunizmi. Nga ana tjetër, vendi ishte në uri të plotë, jetonte me ndihma humanitare, kooperativat bujqësore ishin shkatërruar: toka duhej punuar! Kush ta punonte? Pronarët e para 1945 ishin të struktur nga raprezaljet komuniste të 45 vjetëve, shumë tapi ishin djegur, shumë ishin lëmsh, praktikisht nuk kishte asnjë pronar që në vitin 1991 të mund të posedonte pronën dhe të luante rolin e pronarit, duke prodhuar me të. Bile, edhe fshatarët nuk para ishin gati psikologjikisht ta pranonin tokën edhe si dhuratë: 45 vjet komunizëm ua kishin zbutur ndjenjën e pronës private mbi tokën, paralelisht me shtimin e urrejtjes për punën kolektive. Nuk kishte zgjidhje tjetër: duhej të shpëtonim mbi 60% e popullsisë që rrezikonte edhe jetën nga urija, duhej të bënim pronarë “me zor” fshatarët—e kjo u bë me ligjin 7501. Në këtë kuptim, dhënia e tokës në pronësi fshatarëve e punonjësve të fermave, me ligjet e fillimit të viteve '90, u bë për interes publik: çlirohesh shteti nga detyrimi për të mbajtur me bukë (me ndihma humanitare) edhe fshatin—qyteti, dhe ishte një barë shumë e rëndë. (Natyrisht, motivet e dhurimit të tokës, kanë qenë shumë më komplekse, por këtu po i biem shkurt, për to kemi shkruar gjatë.)

5—Paraqitet si më e drejtë dhënia e tokës pushtuesve të saj, tani me ligjin e “legalizimit”, sesa dhënia e tokës fshatarëve, me ligj (7501) në vitin 1991 Si mund të jetë njësoj një njeri që merr legalisht, p.sh., një shpërblim prej 1 milionë lekë, me një njeri që grabit në bankë 1 milionë lekë?! Aq më keq, si mund të thuhet se janë më në të drejtë ata që grabitën, sesa ata që janë pronësuar me ligj?! Ju kujtojmë se ligji 7501 është miratuar me unanimitet, edhe nga PD-ja, në kohën kur kryeministri ynë ishte kryetar i saj. Natyrisht që as kryeministri vetë s’ka si t’i besojë këto që thote sot. Por edhe ata që kanë grabitur tokat, ata që i dhanë votën më 3 korrik 2005, edhe ata kanë frikë se as atyre nuk do t’ua mbajë fjalën që t’ua japë tokën pa para (me paratë tona)! Edhe ata, grabitësit, i dinë piruetat e atij, kryeministrit aktual, gjatë këtyre 15 vjetëve: herë duke thënë se “e kanë mashtruar të shkretin të majtët brenda PD-së”, herë duke thënë që pronarët “të bëjnë partinë e vet”, e herë se “7501 është ligji më i mirë në botë”, duke u ngrirë gjakun të gjithëve, fshatarëve dhe të gjithë biznesmenëve, duke induktuar pasiguri, duke paralizuar kështu shkëmbimet ekonomike normale me tokën, investimet etj.!

6—Shpresojmë të kemi kontribuar në kthjellimin e mendjes së atyre që i shkojnë mbrapa qorrizi kryeministrit aktual, se shumica dërmuese e shqiptarëve nuk kanë fare nevojë për këto komente e opinione. Të provojë kryeministri të bëjë një referendum popullor për “legalizimet”, dhe do të bindet sesa i pasaktë është edhe kur thotë se ligji i “legalizimeve” ka “marrë mbështetje popullore më shumë se çdo ligj tjetër në historinë e këtij parlamenti”.

Bashkim Koplaku

Durrës, më 25.3.2006